FEDERATA ATLETIKE E KOSOVËS
ATHLETIC FEDERATION OF KOSOVA

Nr.208/2020

Prishtinë më 22.11.2020

Komisioni disiplinor në përbërje të znj.Arta Kelmendi në cilësinë e Kryetares ,zt. Agron Pllana dhe zt. Adnan Tahiri që të dy anëtarë të KD në mbledhjen e mbajtur më datën 22.11.2020 në bazë të nenit 2,3,,11,22,31,34 ,40,të rregullores së, Komisioni Disiplinor I FAK-ut nxjerr këtë vendim

Vendim

Zt. Besart Zeka atlete i K.A."Besa" nga Peja i shqiptohet masa disiplinorë e **Vërejtjes me shkrim** për shkak se në ditën gjatë garave ka ndërmarrë veprimeve të cilat nuk janë në përputhje me sjellje të mira dhe profesionale të një atleti.

Për shkak se

1. Në ditën e garave ka ndërmarr veprime për të cilat nuk ka qenë kompetent as i autorizuar nga ana e FAK-ut për të ndërhyrë në punën e Komisionit të garave për parregullsitë që kanë ndodhur.
2. Sjellja në mënyrë të paedukatë ndaj trajnerit, atletëve apo bashkëpunëtoreve tjerë profesional të klubeve të tjera apo edhe bashkëpunëtorëve të tjerë sportive jashtë FAK-ut
3. Sjellja në ambientin e garave në kundërshtim me rregullat e përgjithshme të moralit dhe sjelljet e bezdisshme me fjalë fyese ndaj garuesve apo edhe gjinisë femërore është e papranueshme me Kodin "etik" të sjelljes së sportive, mundë të ngjallë atmosferë negative dhe konfliktuoze në gara ,me pasoja të pa parashikueshme për trajner, bashkëpunëtor sportive.
4. Me këtë vërejtje besojmë se do të arrihet qëllim i shqiptimit të masave disiplinore në parandalimin e shkeljeve të tjera , dhe rregullimin e raporteve nder personale të atletëve në mes të K.A. "Besa" dhe K.A. "Prizrenit " dhe sjelljet e tilla më nuk do të përsëriten, në të kundërtën do të ndërmerren masa të tjera disiplinore.

ARSYETIM

Komisioni Disiplinor më datën ka pranuar një fletëparaqitje me nr. 103/2020 si parashtrues i ankesës në cilësinë e kryetarit të K.A "Prizreni", lidhur me shkeljen e kryer sipas nenit 2 dhe nenit 22,të KD/FAK-ut nga deklarata e pranuar me nr 129/2020 nga K.A "Besa "Pejë/

Komisioni disiplinor gjatë procedurës disiplinorë të mbajtur më datën 25.10.2020 ka administruar me shkresat e lëndës, Raportin delegatit të garave deklaratën e pranuar me shkrim me nr.pr.124/2020 të datës 27.08.2020,nga deklarata e marrë me shkrim me nr 128/2020. Deklarata e pranuara me shkrim me nr 127/2020 dhe deklaratën e pranuar me shkrim me nr 129/2020. Deklarata e pranuar me shkrim me nr 192/2020, si dhe deklaratat e dëshmitarëve me shkrim me nr.pro.170/2020 të datës 30.10.2020,nr.pro.191/2020 i datës 30.10.2020,nr.pro 122/2020 të datës 19.08.2020.

Në bazë të shkresave të lëndës është vërtetuar se i lartë cekuri ka kryer shkeljen në bazë të nenit 2,nenit 22 të rreg. KD të FAK-ut, dhe në bazë të nenit 6, nenit 10, lidhur me neni 40 nxirët dhe shqiptohet kjo masë .

Andaj ky vendim është I arsyetuar dhe I bazuar në rre.KD/FAK-ut

Shpenzimet procedurale të Komisioni disiplinor i heq FAK-ut në bazë të nenit 36 të rreg. KD/FAK-ut, duke pasur parasysh gjendjen financiare të klubeve të Kosovës si dhe gjendjen momentale të pandemisë COVID 19 të cilën po përballet i tërë globi.

Komisioni Disiplinor
Mr.sc.ArtaKelmendi Kryetare

Zt. Adnan Tahiri Anëtar

Zt. Agron Pllana Anëtar

Këshill juridike
Kundër këtij akt vendimi pala e pakënaqur mundë të parashtroj ankesë në afat prej/8/ditësh në Bordin e FAK-ut si organ I shkallës së dytë

Rr. Agim Ramadani - House of Sport – z.13, Prishtinë, 10 000 Kosovë.
Tel /fax: +381 38 227 380, www.fakosova.org, e-mail: fakosova@yahoo.com
Nr. i llogarisë rrjedhëse: ProCredit Bank 1110-3611150001-26

FEDERATA ATLETIKE E KOSOVËS
ATHLETIC FEDERATION OF KOSOVA

Nr:207/2020

Prishtinë me 22.11.2020

Komisioni disiplinor në përbërje të znj. Arta Kelmendi në cilësinë e Kryetares, zt. Agron Pllana dhe zt. Adnan Tahiri që të dy anëtarë të KD në mbledhjen e mbajtur më datën 22.11.2020 në bazë të nenit 2,3,4,5,12,20,31,34 , 40, të rregullores së, Komisioni Disiplinorë i FAK-ut nxjerr këtë.

VENDIM

Zt. Afrim Belegu, trajner i Klubit Atletik "Besa" nga Peja i shqiptohet masa disiplinorë me ndalim të përfaqësimit gjegjësisht të ushtrimit të profesional të trajnerit si dhe detyra të tjera të përcaktuar nga FAK-ut në gara në periudhën kohore prej 6 muaj, me këtë i ndalohet edhe prezenca ne gara gjatë organizimit të tyre .

ARSYETIM

Komisioni Disiplinor më datën 10.08.2020 ka pranuar një fletëparaqitje me nr. 103/2020 si parashtrues i ankesës në cilësinë e kryetarit të K.A "Prizreni", lidhur me shkeljen e kryer sipas nenit 4 dhe nenit 20, të KD/FAK-ut, deklarata me nr. 127/2020 me datën 31.08.2020, deklarata me nr. 129/2020 me datën 31.08.2020, deklarata me nr. 127/2020 me datën 31.08.2020.
Komisioni disiplinor gjatë procedurës disiplinorë të mbajtur më datën 25.10.2020 ka administruar me shkresat e lëndës, Raportin e delegatit të garave, me deklaratën nr.pr.124/2020 të datës 27.08.2020, nga deklarata e marrë me shkrim me nr. 128/2020 te datës 31.08.2020, si dhe deklarata e marrë me shkrim me nr. 127/2020 të datës 31.08.2020, dhe deklaratës të pranuar me shkrim me nr. 129/2020 të datës 31.08.2020, si dhe deklaratën e pranuar me shkrim me nr. 192/2020 të datës 30.10.2020. Deklaratat e dëshmitarëve me shkrim me nr.pro.170/2020 të datës 30.10.2020,nr.pro.191/2020 I datës 30.10.2020,nr.pro 122/2020 të datës 19.08.2020.
Në bazë të shkresave të lëndës është vërtetuar se i lartë cekuri ka kryer shkeljen në bazë të nenit 4, nenit 5, nenit 20 të rregullores. KD të FAK-ut, dhe në bazë të nenit 6, nenit 10, lidhur me nenin 40 nxirret dhe shqiptohet kjo masë .
Andaj ky vendim është i arsyetuar dhe i bazuar në rregulloren. KD/FAK-ut
Shpenzimet procedurale të Komisioni disiplinor i heq FAK-ut në bazë të nenit 36 të rregullores. KD/FAK-ut, duke pasur parasysh gjendjen financiare të klubeve të Kosovës si dhe gjendjen momentale të pandemisë COVID 19 të cilën po përballet I tërë globi.

Komisioni Disiplinorë
Mr.sc.Arta Kelmendi Kryetare

Zt.Adnan Tahiri Anëtar

Zt. Agron Pllana Anëtar

Këshill juridike
Kundër këtij akt vendimi pala e pakënaqur mundë të parashtroj
ankesë në afat prej/8/ditësh në Bordin e FAK-ut si organ i shkallës së dytë